



USHTRIA




Viti i 78-të i botimit Nr. 28 (827933)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 korrik 2025

ZJARRET KËRCËNOJNË VENDIN Ushtria në frontin e parë të mbrojtjes



VIZITË E RËNDËSISHME NGA BUNDESTAGU GJERMAN NË MINISTRINË E MBROJTJES

Ministria e Mbrojtjes mirëpriti Tilman Kuban, anëtar i Bundestagut gjerman dhe Zëdhënës për Çështjet Evropiane i grupit parlamentar CDU/CSU, si dhe David Preisendanz, deputet dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e Bashkimit Evropian. Gjatë takimit u diskutua mbi angazhimin e ripërtërirë të Gjermanisë në rajonin e Evropës Juglindore, një angazhim që vjen me një qartësi të re strategjike...



faqe 2



ARSIMIMI NË USHTRI, GURTHEMELI I MBROJTJES KOMBËTARE

ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një kohë kur sfidat e sigurisë po marrin trajta të reja, më të sofistikuar dhe më të paparashikueshme, roli i Forcave të Armatosura nuk është më vetëm ai tradicional i mbrojtjes së kufijve fizikë. Sot, një ushtri moderne është një strukturë dinamike, e pajisur me dije, teknologji dhe aftësi për të vepruar në një spektër të gjerë kërcënimesh...



faqe 7



INDRIT CARA, ZEMRA QË RRAHU PËR LIRINË, DRITA QË NUK SHUHET KURRË

54-vjetori i lindjes së heroit kombëtar Indrit Cara -Kujtesë dhe Nderim
Më 11 korrik 2025, në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, u organizua aktiviteti në nderim të jetës dhe veprës të heroit kombëtar Indrit Lulzim Cara, në përvjetorin e tij të 54-të të lindjes. Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e veçantë të z. Adem Ajdini, kryetar i Shoqatës "Shkolla Ushtarake Skënderbej", me mbështetjen...



faqe 8



Takim zyrtar në Tiranë: Admirali Pierre Vandier viziton Shqipërinë

FARSH rikonfirmon përkushtimin ndaj vizionit të NATO-s për transformim dhe përshtatje strategjike. Me një pritje zyrtare dhe diskutime të nivelit të lartë, Shqipëria mirëpriti Admiralin Pierre Vandier, Komandantin e Komandës Supreme të NATO-s për Transformim (Allied Command Transformation – ACT), i cili zhvilloi një vizitë zyrtare në vendin tonë.

Gjatë qëndrimit në Tiranë, Admirali Vandier u prit nga Presidenti i Republikës, Sh.T. z. Bajram Begaj, si dhe nga ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu. Një takim i veçantë u zhvillua gjithashtu me shefin e Shtabit të Përgjithshëm të (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, ku u theksua rëndësia e bashkëpunimit strategjik ndërmjet Shqipërisë dhe strukturave të NATO-s. Diskutimet e zhvilluara u përqendruan në temat kyçe të inovacionit, teknologjisë dhe mësimave të nxjerra nga sfidat aktuale të sigurisë globale.

Palët vlerësuan domosdoshmërinë për një NATO më të aftë të parashikojë dhe t'i përgjigjet në mënyrë efektive ndryshimeve në mjedisin e sigurisë ndërkombëtare. “Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë mbeten të përkushtuara në mbështetje të vizionit të NATO-s për transformim të qëndrueshëm dhe përshtatje të vazhdueshme ndaj sfidave të kohës”, - u shpreh gjenerallejtënant Arben Kingji. Në përmbyllje të vizitës, iu shpreh mirënjohje Admirali Vandier për mbështetjen e tij të vazhdueshme dhe për vizionin e qartë drejt një Aleance më të bashkuar, më fleksibël dhe të fuqizuar përmes avancimit teknologjik dhe kapaciteteve të reja.



Operacion i suksesshëm i Forcave të Armatosura në shuarjen e zjarrit në Drenovë, Mallakastër

MALLAKASTËR – Pas tre ditësh përpjekjesh intensive, u shua plotësisht zjarri që përfshiu masivin pyjor të Drenovës. Operacioni, i cili u zhvillua në kushte jashtëzakonisht të vështira, u finalizua me sukses falë bashkëpunimit të ngushtë të forcave tokësore dhe mbështetjes ajrore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Forcat zjarrfikëse dhe dhjetëra efektivë të FARSH u angazhuan pa ndërprerje në terren me mjete rrethore, për shkak të natyrës së thyer të terrenit, që e bënte të pamundur ndërhyrjen me automjete zjarrfikëse. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme gjatë dy ditëve të para, vatrat aktive vijuan të përhapeshin në disa zona të paarrtshme. Vendimtare për përmbyajtjen e situatës rezultoi ndërhyrja ajrore e Forcës Ajrore, e cila u aktivizua me helikopterin “Cougar” për të ndërhyrë në pikat më të rrezikshme. Krahas helikopterit, u përdor edhe një dron i Detashmentit UAV nga Baza Ajrore e Kuçovës, i cili siguroi vëzhgim të vazhdueshëm dhe orientim të saktë për forcat në terren dhe helikopterin, duke identifikuar me saktësi vatrat më aktive të zjarrit.

Falë këtij koordinimi të shkëlqyer ndërinstitutional dhe përkushtimit maksimal të efektivëve, u arrit të shmanget përhapja e zjarrit në sipërfaqe të tjera pyjore dhe të garantohet siguria e zonave të banuara përreth.

Për t'u vlerësuar veçanërisht është angazhimi i pilotëve dhe i personelit teknik të helikopterit “Cougar”, si dhe i personelit të Bazës Ajrore Farkë, të cilët edhe gjatë fundjavës, në kushte të vështira atmosferike dhe terreni, realizuan fluturime të njëpasnjëshme, duke bërë të mundur shuarjen përfundimtare të flakëve. Ky operacion dëshmoi edhe një herë profesionalizmin, gatishmërinë dhe aftësinë operationale të Forcave të Armatosura për të vepruar me efikasitet në përballimin e emergjencave civile dhe mbrojtjen e komuniteteve.



Vizitë e rëndësishme nga Bundestagu gjerman në Ministrinë e Mbrojtjes

Ministria e Mbrojtjes mirëpriti Tilman Kuban, anëtar i Bundestagut gjerman dhe Zëdhënës për Çështjet Evropiane i grupit parlamentar CDU/CSU, si dhe David Preisendanz, deputet dhe anëtar i Komisionit Parlamentar për Çështjet e Bashkimit Evropian. Gjatë takimit u diskutua mbi angazhimin e ripërtërirë të Gjermanisë në rajonin e Evropës Juglindore, një angazhim që vjen me një qartësi të re strategjike, e cila luan një rol kyç për procesin e integritetit evropian të Shqipërisë. Në fokus të

bisedimeve ishte siguria, fuqizimi i industrisë së mbrojtjes dhe stabiliteti gjeopolitik në kontinent. Këto sfida tejkalojnë kufijtë kombëtarë dhe kërkojnë një qasje të koordinuar, bashkëpunim të ngushtë ndërinstitutional dhe punë në ekip me partnerët tanë ndërkombëtarë. Vizita e delegacionit gjerman nënvizon rëndësinë që Gjermania i kushton zhvillimeve në Ballkanin Perëndimor dhe mbështetjen e vazhdueshme për Shqipërinë në rrugën e saj drejt Bashkimit Evropian.



ZJARRET KËRCËNOJNË VENDIN

Ushtria në frontin e parë të mbrojtjes

Tiranë, 18 korrik 2025 - Gjatë 48 orëve të fundit, situata e zjarreve në Shqipëri ka mbajtur vigjilencën e lartë, me disa vatra aktive që kërkojnë ndërhyrje territoriale intensive.

Bilanci i fundit i zjarreve

Gjatë 24 orëve të fundit Ministria e Mbrojtjes raporton 20-22 vatra të reja në qarqe të ndryshme të vendit.

Prej tyre, 3 vatra janë ende aktive, ndërsa një tjetër është nën monitorim të vazhdueshëm. Zjarret janë regjistruar në qarqe si Dibër, Bulqizë, Fier, Shkodër, Gjirokastrë, Mallakastër, Kavajë, Vlorë, Elbasan, Krujë, Has, Lezhë, Përmet, Mirditë, Mat dhe Vau Dejës.

Fokuset më problematike

Dibër/Bulqizë: Në “Malin e Peladhisë”, zjarri është i riaktivizuar që nga data 13 korrik dhe vijon në lëvizje të ngadaltë drejt fshatrave Vlashaj dhe Krajë. Inkuadrohen rreth 35 forca operacionale në terren.

Qarku Dibër, “Liçeni i Luleve” (Parku Lurë): Zjarri vijon pas ndërhyrjeve intensive për shuarje që prej datës 7 korrik.

Shkodër/Vau Dejës: Vatër aktive në “Qafën e Lacit” prej dy ditësh, përfshin sipërfaqe me lis dhe shkurre.

Roli i Ministrisë së Mbrojtjes

Ministria drejton dhe koordinon njësi të ndryshme për emergjencat civile dhe forcat e armatosura në terren:

Qendra Kombëtare Operacionale e Emergjencave Civile (AKMC) mbledh dhe transmeton informacion në kohë reale për vatrat e zjarrit.

Forcat Operacionale: Rreth 305-362 forca, përfshi 25-30 makina zjarrfikëse dhe 2-4 helikopterë, janë angazhuar në terren për shuarje dhe monitorim.

Roli i Forcave Ajrore: Përdorimi i dronëve nga baza e Kuçovës për monitorim 24 orë në zonat jugore (Himarë, Vlorë, Përmet), duke siguruar informacion real time për qarkullimin e flakëve dhe dërguar mbështetje ajrore në kohë.

Ministria e Mbrojtjes apelon për evitimin e ndezjes së zjarreve në natyrë dhe raporte të menjëhershme në rast dyshimi.



Gjeneralmajor Ferdinand Dimo përfaqëson Shqipërinë në Konferencën Globale të Komandantëve të Forcave Ajrore të NATO-s në Londër

LONDËR, 2025. Komandanti i Forcës Ajrore, gjeneralmajor Ferdinand Dimo, mori pjesë në Konferencën Globale të Komandantëve të Forcave Ajrore të vendeve anëtare të NATO-s dhe Shefave të Shtabeve të Hapësirës dhe Ajrit, e cila po zhvillohet në Londër.

Kjo pjesëmarrje e rëndësishme konfirmon angazhimin e Forcës Ajrore shqiptare për të ndjekur zhvillimet më të fundit në fushën e mbrojtjes ajrore dhe hapësinore, si dhe për të forcuar bashkëpunimin me partnerët strategjikë të Aleancës në funksion të sigurisë kolektive dhe stabilitetit në rajon.

Gjatë konferencës, gjeneralmajor Dimo ka zhvilluar takime dypalëshe me Komandantin e Forcës Ajrore të Rumanisë si dhe me Zëvendëskomandantin e Bazës Ajrore të Ramstein. Në këto takime është diskutuar mbi forcimin e bashkëpunimit ushtarak, shkëmbimin e përvojave në trajnimet profesionale, si dhe rritjen e kapaciteteve operacionale të Forcës Ajrore shqiptare. Një vëmendje e veçantë iu kushtua fushave të zbulimit ajror, teknologjisë së mirëmbajtjes së mjeteve ajrore dhe integritetit të kapaciteteve të reja në përputhje me standardet e NATO-s.

Pjesëmarrja e përfaqësuesit të Forcës Ajrore shqiptare në këtë forum strategjik nënvizon përkushtimin e Shqipërisë ndaj mbrojtjes kolektive dhe kontribuon në rritjen e ndërveprueshmërisë me forcat aleate.



Ish-reparti ushtarak në Bushat kthehet në Qendër Rajonale të Emergjencave Civile

Ish-reparti ushtarak i Forcave të Armatosura në Bushat po i nënshtrohet një transformimi të rëndësishëm, duke u kthyer në një Qendër Rajonale të Emergjencave Civile, në funksion të përballimit të situatave të jashtëzakonshme dhe fatkeqësive natyrore në veri të vendit.

Ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, i shoqëruar nga drejtori i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, z. Haki Çako, prefektja e qarkut Shkodër, znj. Majlinda Angoni dhe komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, zhvilluan një vizitë inspektuese në ambientet e repartit, ku po kryhen punimet për rehabilitimin e tij.

Gjatë inspektimit, ministri Vengu theksoi se ky projekt është pjesë e një iniciative të gjerë të Ministrisë së Mbrojtjes për të rivlerësuar dhe kthyer në funksion civil e ushtarak asetet e amortizuara të Forcave të Armatosura. “Në bashkëpunim me Komandën Mbështetëse, Prefekturën e Shkodrës dhe Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, kemi vendosur që ky ish-repart, i lënë pas dore për vite me radhë, të shndërrohet në një strukturë moderne e të gatshme për t’u përballur me emergjencat natyrore”, - deklaroi ministri.

Qendra e re synon të mbështesë kapacitetet



reaguese të bashkive të Shkodrës dhe Lezhës, me fokus të veçantë në zonën ndërmjet Shëngjinit dhe Velipojës, ku fluksi turistik i shtuar rrit edhe rreziqet potenciale gjatë gjithë vitit. Ajo do të funksionojë si një nyje bashkërendimi për reagimin ndaj zjarreve, përmbajtjeve dhe fatkeqësive të tjera natyrore.

Ministri Vengu bëri me dije se puna për rehabilitimin ka nisur dhe po zhvillohet falë angazhimit të Komandës Mbështetëse, e cila ka garantuar aksesin dhe përgatitjen e ambientit për zbatimin e projektit. Kjo qendër rajonale përforcon angazhimin e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Mbrojtjes Civile për një reagim më efikas dhe të koordinuar ndaj emergjencave, si dhe kontribuon në ndërtimin e një infrastrukture moderne në shërbim të sigurisë së komunitetit.

Anija “Oriku” e Forcës Detare, në stërvitjen ndërkombëtare “Adrion Livex 25” në Mal të Zi

TIVAT, MAL I ZI – Anija patrulluese “Oriku” e Forcës Detare/Rojës Bregdetare të Republikës së Shqipërisë mori pjesë në stërvitjen ndërkombëtare “Adrion Livex 25”, e zhvilluar në ujërat territoriale të Malit të Zi.

Kjo stërvitje, e përvitshme dhe me karakter shumëpalësh, kishte për qëllim rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërveprueshmërisë midis forcave detare të vendeve pjesëmarrëse në fushat e sigurisë detare, zbatimit të ligjshmërisë në det, operacioneve të kërkim-shpëtimit dhe sigurisë së lundrimit.

Në këtë aktivitet morën pjesë gjashtë shtete të rajonit të Adriatikut dhe Jonit, të cilat kontribuan me njësi detare dhe personel të specializuar. Stërvitja u zhvillua në dy faza të veçanta: faza përgatitore në port dhe faza taktike në det të hapur, ku ekuipazhet trajtuan skenarë realistë që përfshinin operacione bordimi, reagim ndaj kërcënimeve asimetrike, luftë kundër zjarrit dhe menaxhim të situatave emergjente me hyrje uji në bord.

Gjatë Ditës së Vizitorëve të Shquar (Distinguished Visitors Day), komandanti i Forcës Detare/Rojës Bregdetare të Shqipërisë, nënadmiralet Adnand Agastra, mori pjesë në aktivitetet zyrtare së bashku me përfaqësues të lartë ushtarakë nga vendet pjesëmarrëse. Në kuadër të këtij takimi, nënadmiralet Agastra zhvilloi një takim me kryetarin e Bashkisë



së Tivatit, ku u diskutua mbi rëndësinë e bashkëpunimit civil-ushtarak dhe rolin e aktiviteteve të përbashkëta për forcimin e sigurisë në rajon.

Pjesëmarrja e anijes “Oriku” në këtë

stërvitje ndërkombëtare dëshmon edhe një herë angazhimin e Shqipërisë për sigurinë detare, si dhe përforcon rolin aktiv të Forcës Detare në kuadër të aleancës dhe partneritetit me vendet anëtare të NATO-s dhe ato partnere në rajon.



Stërvitjet “Durrësi SAREX 25” & “Redoni Blu 25”

Nën drejtimin e Forcës Detare/Rojës Bregdetare në bashkëpunim dhe me strukturat shtetërore me detyrime në fushën e kërkim-shpëtimit dhe reagimit ndaj ndotjeve në det u zhvilluan me sukses stërvitjet “Durrësi SAREX 25” dhe “Redoni Blu 2025” në rajonin Durrës-Kepi i Palit.

Qëllimi i stërvitjeve ishte testimi i kapaciteteve operacionale, rritja e ndërveprueshmërisë në situata emergjente dhe demonstrimi i gatishmërisë për operacione kërkim-shpëtimit dhe përballimin e ndotjeve detare.

Në stërvitje u angazhuan mjete detare, ajrore dhe tokësore të Forcës Detare, Forcës Ajrore, Qendrës Kombëtare të Kërkim-Shpëtimit, Autoritetit Portual Durrës, Policisë Kufitare dhe institucione të tjera që kontribuan me personel dhe pajisje mbështetëse. Gjatë zhvillimit të Ditës së Vizitorëve të Shquar, me pjesëmarrjen e autoriteteve të larta civile dhe ushtarake, komandanti i Forcës Detare nënadmiralet Adnand Agastra vlerësoi angazhimin, profesionalizmin dhe bashkëpunimin institucional si dëshmi e kapaciteteve për përballimin e sfidave detare në kohë reale.

Forca Detare mbetet një faktor kyç për sigurinë kombëtare detare dhe reagimin e koordinuar ndaj emergjencave në hapësirën detare të Shqipërisë.

Efektivët e Komandës Mbështetëse realizojnë me sukses operacionin për asgjësimin e municioneve në poligonin Mnelë

Një tjetër detyrë e rëndësishme është realizuar me sukses nga efektivët e Komandës Mbështetëse, të cilët kanë mbështetur strukturat e Forcave të Armatosura në një operacion të specializuar për vlerësimin dhe asgjësimin e municioneve të hedhura dhe të paplasura.

Në bashkëpunim me Regjimentin e Këmbësorisë së Veriut, janë angazhuar forcat e Kompanisë EOD (Explosive Ordnance Disposal), të pajisura me mjete dhe pajisje speciale, për të garantuar sigurinë e poligonit të qitjeve në Mnelë. Ky operacion, i kryer me profesionalizëm dhe përkushtim, siguroi jo vetëm zonën e poligonit, por edhe hapësirat përreth, duke i kthyer ato në një ambient të sigurt për zhvillimin e mëtejshëm të stërvitjeve ushtarake.

Komanda Mbështetëse, përmes kapaciteteve të saj operacionale dhe ekspertizës së njësive të saj të specializuara, vazhdon të luajë një rol thelbësor jo vetëm në mbështetje të popullsisë civile, por edhe të strukturave të tjera të Forcave të Armatosura. Ky operacion konfirmon edhe një herë rëndësinë strategjike të kësaj komande në garantimin e sigurisë dhe gatishmërisë operacionale të ushtrisë shqiptare.



Gjeneral brigade Aleksandër Pando, vizitë zyrtare në Letoni: Vlerësohet angazhimi i Kontingjentit XVII EOD

Komandanti i Komandës Mbështetëse, gjeneral brigade Aleksandër Pando, zhvilloi një vizitë zyrtare në Kamp Adazi, Letoni, ku është dislokuar Kontingjenti XVII EOD, pjesë e Brigadës Shumëkombëshe të NATO-s, në kuadër të Prezencës së Përpëruar.

Gjatë vizitës, gjeneral brigade Pando inspektoi efektivët shqiptarë të dislokuar në këtë mision ndërkombëtar, duke u njohur nga afër me detyrat që ata kryejnë, misionin e tyre dhe kapacitetet teknike që përdorin në fushën e EOD/IEDD. Ai shprehu vlerësimin e tij të lartë për profesionalizmin, përkushtimin dhe përfatësimin dinjitoz të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në këtë angazhim të rëndësishëm ndërkombëtar.

Në vijim të vizitës, gjeneral brigade Pando zhvilloi një takim me Komandantin e Brigadës Shumëkombëshe, kolonel Reeves, ku u rikonfirmua mbështetja e ndërsjellë dhe rëndësia strategjike e vijimit të pjesëmarrjes së kontingjenteve shqiptare në këtë mision të NATO-s në Letoni.

Në kuadër të kësaj vizite, u organizua edhe një ceremoni përkujtimore në nderim të efektivëve shqiptarë të rënë në krye të detyrës në Letoni. Në ceremoni morën pjesë edhe ministri për Evropën dhe Punët e Jashtme, z. Igli Hasani, dhe ambasadorja e Shqipërisë në Poloni, znj. Mimoza Halimi. Të dy përfaqësuesit e lartë shtetërorë zhvilluan gjithashtu një takim me efektivët e kontingjentit shqiptar, ku shprehën mirënjohjen dhe mbështetjen e plotë të shtetit shqiptar për kontributin e tyre në forcimin e sigurisë kolektive dhe imazhit të Shqipërisë në skenën ndërkombëtare.

FORCAT E
Armatozura



Një shekull në shërbim të jetës, kombit dhe ushtarit shqiptar

Më 16 korrik 1924, në një Shqipëri që sapo kishte nisur rrugëtimin e saj drejt ndërtimit të institucioneve shtetërore moderne, u hodh një nga hapat më të rëndësishëm në fushën e shëndetit publik, krijimi zyrtar i Shërbimit të Shëndetësisë Shqiptare. Ky institucion lindi në një kohë sfiduese, kur mungonin mjekë të specializuar, infrastruktura ishte e kufizuar dhe sëmundjet infektive ishin kërcënim i përditshëm. Megjithatë, vullneti për të krijuar një shërbim shëndetësor kombëtar, të organizuar, të qëndrueshëm dhe në funksion të popullatës dhe strukturave shtetërore, përfshirë ushtrinë ishte i pathyeshëm.

Roli themelor në mbrojtjen e jetës së ushtarit

Që nga fillimet e tij, Shërbimi i Shëndetësisë pati një mision të qartë, të përkujdeset për shëndetin e ushtarakëve shqiptarë. Në vitet '20 e më tej, përpjekjet për ndërtimin e një ushtrie kombëtare nuk mund të konceptoheshin pa strukturat shëndetësore që do të siguronin jetën dhe gatishmërinë e trupave.

Mjekët ushtarakë, shumë prej të cilëve kishin studiuar jashtë vendit, u angazhuan për të ngritur njësi sanitare brenda reparteve, duke përfshirë infermierë, laborantë, farmacistë dhe më pas edhe kirurgë ushtarakë. Njëkohësisht, ushtria shqiptare mori masa për të përfshirë elementë të parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve në mjediset ushtarake, një hap i avancuar për kohën.

Rritje graduale përmes dekadave

Me kalimin e viteve, sidomos pas Luftës së Dytë Botërore, Shërbimi i Shëndetësisë Shqiptare nisi të marrë formë më të konsoliduar. U ndërtuan spitale ushtarake, si ai i Tiranës dhe i Durrësit, u krijuan struktura mjekësore mobile për situata emergjente, si edhe filluan programet e trajnimit për mjekësi ushtarake në Akademinë e Mjekësisë dhe në institucionet ushtarake arsimore.

Në vitet 1960–1980, shëndetësia ushtarake u bë pjesë integrale e përgatitjes për situata të jashtëzakonshme, me ekipe mjekësore të gatshme për reagim në rast lufte apo fatkeqësish natyrore. Në të njëjtën kohë, për herë të parë u aplikua koncepti i ushtrisë si garant i shëndetit publik, sidomos në zonat e thella ku mjekësia civile mungonte.

Periudha e tranzicionit dhe modernizimi

Pas vitit 1990, përballë ndryshimeve të mëdha politike dhe ekonomike, Shërbimi i Shëndetësisë përjetoi një fazë transformimi të thellë. Me gjithë vështirësitë fillestare, ai ruajti misionin e vet strategjik në shërbim të Forcave



Shërbimi i Shëndetësisë, 101 vjet përkushtim, histori që vazhdon



të Armatosura dhe u përshtat me standardet bashkëkohore të NATO-s, veçanërisht pas integritetit të Shqipërisë në Aleancë.

Sot, Forcat e Armatosura Shqiptare disponojnë një strukturë moderne të mbështetjes shëndetësore, me personel të trajnuar në misione ndërkombëtare, kapacitete për ndërhyrje të menjëhershme, bashkëpunim me strukturat e emergjencës civile dhe njësi sanitare të lëvizshme për operacione brenda dhe jashtë vendit. Puna e mjekëve, infermierëve, teknikëve laboratorikë dhe oficerëve shëndetësorë brenda strukturave ushtarake përfaqëson një vlerë të jashtëzakonshme për vendin. Ajo është dëshmi e profesionalizmit, sakrificës dhe besnikërisë ndaj misionit: të mbrojmë jetën dhe shëndetin e ushtarit shqiptar.

Në këtë përvjetor të veçantë, gazeta “Ushtria” shpreh mirënjohje për të gjithë ata që i kanë shërbyer këtij institucioni me përkushtim, nga vitet e vështira të fillimit e deri në standardet e larta të sotme.

Gëzuar 101-vjetorin, Shërbim i Shëndetësisë Shqiptare!



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Në një kohë kur sfidat e sigurisë po marrin trajta të reja, më të sofistikuar dhe më të paparashikueshme, roli i Forcave të Armatosura nuk është më vetëm ai tradicional i mbrojtjes së kufijve fizikë. Sot, një ushtri moderne është një strukturë dinamike, e pajisur me dije, teknologji dhe aftësi për të vepruar në një spektër të gjerë kërcënimesh nga lufta kibernetike deri te operacionet paqeruajtëse ndërkombëtare. Në këtë realitet të ri, arsimimi i trupës dhe lidhshimit ushtarak nuk është më luks, por domosdoshmëri strategjike.

Arsimimi si themel i profesionalizmit ushtarak

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë kanë ndërmarrë një proces të pandërprerë profesionalizimi. Në zemër të këtij procesi qëndron arsimimi si përgatitje teknike, formim strategjik dhe edukim etik. Akademia e Forcave të Armatosura, Qendra për Edukimin Profesional Ushtarak dhe bashkëpunimet me partnerët ndërkombëtarë, përbëjnë një infrastrukturë akademike që synon të formojë ushtarin e shekullit XXI: të disiplinuar, të shkolluar, të aftë për të vendosur në kushte presioni dhe të ndërveprueshëm me aleatët.

Ky proces nuk duhet parë si një investim thjesht në dije, por si kapital kombëtar për sigurinë. Sepse ushtria nuk ka të bëjë vetëm me armë ajo ka të bëjë me mendje të përgatitura, që dinë të lexojnë situatën, të udhëheqin me maturi dhe të mbrojnë me vizion.

Produkti i arsimit ushtarak, një prioritet që sjell rezultate

Falë reformave të ndërmarrë në dekadën e fundit, Forcat e Armatosura shqiptare kanë arritur të ndërtojnë një trupë oficerësh e nënoficerësh me standarde ndërkombëtare. Pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse të NATO-s, misionet në Kosovë, Bosnje, Afganistan e më gjerë, janë dëshmi konkrete e faktit se arsimimi ushtarak nuk është një qëllim në vetvete, por një instrument real i politikës së mbrojtjes.

Produkti: një ushtarak i kualifikuar, i aftë për të përballuar situata të ndërlikuara, për të operuar në terrene ndërkombëtare dhe për të përfaqësuar Shqipërinë me dinjitet është një pasuri kombëtare. Një pasuri që duhet ruajtur, mbështetur dhe zgjeruar.

Një prioritet që kërkon përkushtim të vazhdueshëm

Për të ruajtur e thelluar këto arritje, kërkohet një politikë e qëndrueshme arsimore brenda sistemit të mbrojtjes. Kjo nënkupton: Modernizimin e kurrikulave në përputhje me standardet e NATO-s; Rritjen e investimeve në laboratorë, teknologji dhe trajnime të avancuara;

Nxitjen e bashkëpunimit me universitetet civile për disiplina të reja si siguria kibernetike, inteligjenca artificiale dhe drejtimi strategjik. Në një botë ku luftërat nuk bëhen më vetëm në fushën e betejës, por edhe në laboratorë, platforma digjitale dhe hapësira diplomatike, arsimimi bëhet arma më e fuqishme që një ushtri mund të ketë.

Investimi në dije është investim në siguri

Shqipëria, si anëtare e NATO-s, nuk mund të kënaqet me minimumin. Forcat tona të Armatosura duhet të qëndrojnë në pararojë, jo vetëm në përkushtim dhe sakrificë, por edhe në dije dhe profesionalizëm. Prandaj, arsimimi ushtarak duhet të trajtohet si një prioritet absolut i mbrojtjes kombëtare, jo vetëm për sot, por për sigurinë e brezave që vijnë.

Zhvillimi i arsimit dhe harmonizimi i Edukimit Ushtarak në ditët e sotme

Arsimi ka qenë gjithmonë një nga shtyllat kryesore të zhvillimit shoqëror dhe kombëtar. Ndërsa shoqëritë evoluojnë, edhe format dhe përmbajtja e edukimit pësojnë ndryshime të thella. Në këtë kontekst, arsimi ushtarak ka ndjekur një trajektore të ngjashme, duke kaluar nga qasjet tradicionale të disiplinës dhe urdhrit, në qasje moderne të bazuara në dije, aftësi shumëdimensionale dhe bashkëpunim ndërkombëtar.

Zhvillimi i arsimit ndër vite

Historikisht, arsimi ishte i privilegjuar për shtresat e larta dhe përqendrohej në ruajtjen e traditave kulturore dhe fetare. Me kalimin e kohës, u institucionalizua dhe u demokratizua, duke u bërë gjithnjë e më i aksesueshëm. Në epokën moderne, arsimi synon jo vetëm përcimin e njohurive, por edhe zhvillimin e aftësive kritike, kreativitetit dhe përshtatshmërisë me një botë që ndryshon

Arsimimi në Ushtri, gurthemeli i Mbrojtjes Kombëtare



me ritme të shpejta. Ky evolucion ndikon drejtpërdrejt edhe në mënyrën si trajnohen dhe edukohen pjesëtarët e Forcave të Armatosura.

Koncepti i arsimit ushtarak në ditët e sotme

Arsimi ushtarak modern është një proces i vazhdueshëm, i ndërlikuar dhe i strukturuar sipas standardeve të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai nuk kufizohet më vetëm në përgatitjen fizike apo aftësitë taktike. Oficerët dhe ushtarakët sot trajnohen në fusha si lidhshimi strategjik, siguria kibernetike, teknologjitë e reja, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.

Gjithashtu, arsimi ushtarak modern përfshin edhe zhvillimin etik dhe qytetar të pjesëtarëve të ushtrisë, duke i përgatitur ata të jenë jo vetëm luftëtarë, por edhe përfaqësues të denjë të shtetit në misionet paqeruajtëse dhe humanitare.

Qasja dhe harmonizimi i edukimit dhe trajnimit në Forcat e Armatosura

Për të përballuar sfidat moderne të sigurisë, Forcat e Armatosura të vendeve demokratike (përfshirë Shqipërinë dhe Kosovën) kanë ndërmarrë reforma thelbësore në mënyrën e edukimit dhe trajnimit. Këto përfshijnë: Integrimin me arsimin civil: Partneriteti me universitetet dhe institucione akademike për të ofruar diploma dhe certifikime për ushtarakët në fusha të tilla si drejtimi, teknologjia informative, marrëdhëniet ndërkombëtare, etj.

Standarde ndërkombëtare: Përdorimi i manualeve dhe programeve të trajnimit sipas standardeve të NATO-s dhe Bashkimit Evropian, për të mundësuar ndërveprueshmërinë në misione shumëkombëshe.



Edukimi i vazhdueshëm: Zhvillimi i kurseve periodike, simulimeve taktike, trajnimeve praktike dhe përdorimi i teknologjive të avancuara për edukimin në distancë. Arsimi, si në aspektin civil ashtu edhe ushtarak, është bërë më gjithëpërfshirës, më i sofistikuar dhe më i ndërlidhur me kërkesat e kohës. Forcat e Armatosura janë duke kaluar nga një model tradicional i trajnimit, në një sistem të plotë të zhvillimit profesional dhe intelektual, në përputhje me kërkesat e mbrojtjes moderne dhe angazhimeve ndërkombëtare. Vetëm përmes një edukimi të qëndrueshëm dhe të harmonizuar, ushtria mund të përmbushë me sukses misionin e saj në një botë gjithnjë e më të ndërlikuar.

“West Point” është një nga akademitë më prestigjioze ushtarake në botë, e themeluar në vitin 1802 në SHBA. Ajo ofron një edukim të plotë akademik dhe ushtarak për oficerë të ardhshëm të Ushtrisë Amerikane.

Në Shqipëri Akademitë Ushtarake janë më të reja dhe të ndërtuara mbi përvoja kombëtare dhe ndihmën e NATO-s, me qëllim krijimin e një korpusi oficerësh profesionalë, të përgatitur sipas standardeve euro-atlantike.

Modelet e lidhshimit dhe kultura akademike

“West Point” kultivon një kulturë shumë të strukturuar dhe meritokratike, me theks te nderi, disiplina dhe përgjegjësia ndaj kombit. Akademia shqiptare është gjithnjë e më shumë në transformim drejt këtij modeli.

Ndikimi i përbashkët i NATO-s dhe bashkëpunimit ndërkombëtar

Oficerët shqiptarë e kosovarë shpesh ndjekin trajnime shtesë në akademi partnere, përfshirë edhe në SHBA.

Ngjashmëritë: Të dyja sistemet synojnë të prodhojnë oficerë të përgatitur për të udhëhequr në kohë paqeje dhe lufte.

Edukimi i integruar (akademik + ushtarak) është baza e formimit profesional.

Dallimet: Qasja amerikane është më e thelluar dhe më e financuar, me një traditë mbi 200-vjeçare. Shqipëria dhe Kosova janë në proces të përparuar harmonizimi me këtë model.

Produkti i arsimit ushtarak: një prioritet i mbrojtjes

Oficerë dhe nënoficerë të kualifikuar me njohuri strategjike dhe teknike; Kapacitete më të larta operacionale në misione brenda dhe jashtë vendit; Aftësi për planifikim, menaxhim dhe drejtim të operacioneve ushtarake; Formim moral dhe etik i lartë – vendimtar për ruajtjen e integritetit dhe besueshmërisë së ushtrisë.

Një ushtri moderne ndërtohet me arsim

Në kohët moderne, fuqia e një ushtrie nuk matet vetëm me numrin e trupave apo arsenalit, por me nivelin e njohurive, përgatitjes dhe profesionalizmit të personelit të saj. Shqipëria, si një shtet që synon të mbajë një rol aktiv në sigurinë rajonale dhe globale, duhet ta ketë arsimimin ushtarak si një prioritet absolut të mbrojtjes kombëtare.



54-vjetori i lindjes së heroit kombëtar Indrit Cara

- Kujtesë dhe Nderim

Më 11 korrik 2025, në auditoriumin e Ministrisë së Mbrojtjes, u organizua aktiviteti në nderim të jetës dhe veprës të heroit kombëtar Indrit Lulzim Cara, në përvjetorin e tij të 54-të të lindjes.

Aktiviteti u zhvillua nën kujdesin e veçantë të z. Adem Ajdini, kryetar i Shoqatës “Shkolla Ushtarake Skënderbej”, me mbështetjen e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Një tubim solemn dhe emocionues

Të pranishëm në këtë ceremoni ishin personalitete të larta të strukturave ushtarake, bashkëluftëtarë të heroit, ish-skënderbegas, ushtarakë aktivë dhe veteranë, qytetarë nga Kavaja, miq e të afërm të Indritit, dhe shumë dashamirës të çështjes kombëtare. Aktiviteti u moderua nga e mirënjohura Hygerta Sako, duke i dhënë dinjitet e solemnitete të veçantë këtij event.

Pas intonimit të himnit kombëtar, u transmetua një dokumentar prekës mbi jetën dhe sakrificën e heroit, duke sjellë në kujtesën e të pranishmëve rrugëtimin e tij atdhetar.

Indrit Cara, nga Kavaja në frontin e lirisë

Indrit Cara lindi më 11 korrik 1971, në Kavajë. Pas përfundimit të arsimit fillor në vendlindje dhe të mesmit në Tiranë në Shkollën Ushtarake “Skënderbej”, ai emigroi fillimisht në Itali dhe më pas në Londër. Në vitin 1999, në kulmin e luftës në Kosovë, ai iu bashkua Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke dhënë jetën më 31 mars 1999 në majën e Gallushës, Suharekë.

Fjalime të ndjera dhe homazhe

Kryetari i Shoqatës “Skënderbej”, z. Adem Ajdini, në fjalën e tij theksoi se “Indriti ishte një djalosh me shpirt luftarak e zemër luani, që la Londrën për të luftuar për Kosovën. Ai është një hero i vërtetë, një model i vetëdijes kombëtare.”

Z. Aleksandër Çipa, kryetar i Unionit të Gazetarëve, e cilësoi aktin e tij si një nga rastet më unike të vetëflijimit për atdhe. Edhe kolonel Besim Gashi, bashkëluftëtar i Indritit, solli momente emocionuese nga fronti, duke e quajtur Indritin “birin e Shqipërisë që u bë biri i Kosovës.”

Fjalime të ngrohta dhanë edhe z. Islam Veliu, ish-kryetar i Bashkisë Kavajë, z. Adem Shehi nga Brigada 153 e UÇK-së, si dhe z. Ali Hasani, i cili e përfshiu heroin në stendën e muzeut të Shoqatës Malziu në Kukës, duke i dorëzuar familjes një certifikatë mirënjohjeje.

Mesazhi i familjes dhe arti në shërbim të kujtimit

Z. Adhurim Cara, familjar i heroit, falënderoi organizatorët dhe theksoi se Indriti ishte “simbol i guximit dhe idealizmit”, ndërsa poezia e Leta Ajdinit, interpretuar mjeshtërisht nga regjisor i Xhelil Aliu, preku thellë zemrat e të pranishmëve.

Këngëtar i Ilir Shaqiri dhe tenori Kastriot Tusha sollën këngë të përkushtuara për heroin, ndërsa në fund të aktivitetit u këndua

Indrit Cara, Zemra që rrahu për Lirinë, Drita që nuk shuhet kurrë



himni i pavdekshëm “Mora fjalë” nga Shkurte Fejza.

Fjalët përmbyllëse: Kolonel Altin Gjetaj, zëvendëskomandant i Akademisë së Forcave të Armatosura, e kujtoi Indritin si një model të formimit ushtarak, brumosur me trinomin “Atdheu – Nderi – Detyra”, duke theksuar rëndësinë e përkujtimit të heronjve kombëtarë për edukimin e brezave.

Ky aktivitet i përkushtuar ishte një buqetë simbolike me lule nga të gjitha trevat shqiptare, një homazh i denjë për një figurë që me jetën dhe sakrificën e tij ka ndriçuar rrugën e lirisë sonë kombëtare. Me përkushtimin e Adem Ajdinit dhe gjithë të tjerëve, Indrit Cara qëndron sot në piedestalin e nderit, si një nga bijtë më të ndritur të kombit shqiptar.

Lavdi përjetë heroit kombëtar Indrit Cara!



Skënder Doçi, Skënderbegasi që udhëhoqi Flotën Luftarake Detare dhe sfidoi kohën

Redaksia e gazetës "Ushtria" sjell në vëmendje për brezat e rinj të gjithë ata burra dhe gra në uniformën ushtarake, të cilët kanë dhënë një kontribut të vyer në shërbim të kombit shqiptar. Mirënjohje dhe përlujë për punën tuaj të pakohë! Pjesë e kësaj elite janë ish-komandant i Flotës Detare, Skënder Doçi dhe Komandanti i parë i nëndetëseve Petrit Myftiu.

Në historinë e Forcave të Armatosura të Shqipërisë, pak figura ushtarake kanë lënë një gjurmë aq të thellë sa Skënder Doçi, një burrë nga zemra e Tropojës, i lindur më 15 prill 1936, që mbartte në gjak atdhedashurinë dhe shpirtin luftarak të brezave të tij.

Djali i Veli Niman Doçit, komandant i Brigadës 25-Sulmuese gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, Skënderi u rrit në frymën e legjendave kreshnike dhe heroizmit të Bacës Bajram Curri, duke përthithur që fëmijë ndjenjat më të pastra të patriotizmit.

Pas përfundimit të shkollës tetëvjeçare, ai iu përkushtua edukimit ushtarak në Shkollën "Skënderbej", për të vazhduar më tej studimet në Shkollën e Lartë të Marinës "Kirov" në Baku, në ish-Bashkimin Sovjetik. Aty, si student shembullor dhe për katër vjet përgjegjës i grupit të studentëve shqiptarë, u dallua për maturinë, përgjegjshmërinë dhe rezultatet e shkëlqyera.

Me kthimin në Atdhe, nisi rrugëtimin e tij në radhët e Nëndetëseve, atëherë njësi e re dhe elitare e Flotës Luftarake Detare. Brenda një kohe të shkurtër, përgatitja e gjithanshme, vendosmëria dhe qetësia në komandim, e ngritën në pozitën e komandantit të Nëndetësës së Dytë në vitin 1961. Guximi dhe profesionalizmi i tij u shfaqën më qartë se kurrë gjatë përplasjeve me oficerët sovjetikë, të cilët tentuan sabotimin dhe grabitjen e dokumentacionit ushtarak. Skënderi, me trimëri dhe vigjilencë, i mbrojtë ato si pasuri të shenjta të ushtrisë shqiptare. Ai nuk pranoi të



dorëzonte as armatimin personal, duke ruajtur nderin dhe autoritetin e një ushtaraku shqiptar.

Për vite me radhë, shërbeu me devotshmëri në Brigadën e Nëndetëseve, si zëvendëskomandant, komandant dhe komisar. Më pas, ai mbajti detyra të larta si komisar i Bazës Ushtarake Detare në Sazan dhe në Vlorë, për të përmbyllur karrierën si Komisar i Flotës Luftarake Detare, një pozicion ku vlerat e tij politike, ushtarake dhe njerëzore spikatën fuqishëm.

Pas daljes në pension, ai emigroi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, por zëri i Atdheut nuk reshti kurrë së thirruri. Me fillimin e luftës në Kosovë, Skënderi rikthehet në arenën e betejës, kësaj here si komandant i batalionit "Atlantik" të UÇK-së, i formuar nga shqiptarët e Amerikës dhe i përkushtuar çlirimit të Kosovës.

Përveçse një ushtarak brilant, Skënder Doçi ishte edhe sportist i talentuar, në futboll dhe voleyboll, që mund të kishte shkëlqyer në arenën sportive po të mos ishte thirrur nga detyra e nëndetësës. Por mbi të gjitha, ai mbetet në kujtesën e kolegëve si njeri shpirtgjërë, i urtë, i dashur dhe me fjalën e mbajtur.

Skënder Doçi është nga ata burra që sfidojnë jo vetëm detin e trazuar, por edhe kohën. Shembulli i tij mbetet një thesar për brezat që do të vijnë, një komandant, një patriot, një figurë që ndriçon me dinjitet faqet e historisë sonë ushtarake.

Petrit Myftiu, Komandanti i parë i nëndetëseve shqiptare, kujtesa e lavdisë detare

Në gjirin e historisë moderne të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, Petrit Myftiu zë vend të veçantë si komandanti i parë i nëndetëseve shqiptare, një pionier i vërtetë që sfidoi detin dhe kohën, dhe që më pas, përmes penës, dokumentoi me dinjitet dhe pasion rrugëtimin e Flotës Luftarake Detare shqiptare.

Lindur më 7 prill 1937, në Elbasan, në një familje të njohur për ndjenjat atdhetare dhe përkushtimin ndaj arsimit, Petriti trashëgoi që në fëmijëri ndjenjën e lartë të përgjegjësisë. Babai i tij, Ali Myftiu, i shpallur "Mësues i Popullit", ishte një nga figurat më të ndritura të arsimit shqiptar, dhe një shkollë në Elbasan mban me krenari emrin e tij.

Petriti nisi rrugën ushtarake në bankat e Shkollës "Skënderbej" (1949-1952), ku u dallua për zgjuars, disiplinë dhe vullnet të hekurt. Dërgohet për studime në Akademinë Ushtarake-Detare në Baku (Azerbajxhan), ku u diplomua me Medaljen e Artë dhe me emrin e skalitur në tabelën e nderit të shkollës, një dëshmi e përkushtimit dhe nivelit të tij të jashtëzakonshëm.

Me përfundimin e Akademisë, Petrit Myftiu emërohet në bazën ushtarake detare të Pashalimanit, ku nisi një kapitull i ri për ushtrinë shqiptare, ndërtimi i Brigadës së Nëndetëseve. Ai ishte ndër të parët që kontribuoi në vendosjen dhe organizimin e kësaj arme të re, duke u bërë zëvendëskomandant në moshën vetëm 20-vjeçare, e më pas komandanti i parë shqiptar i nëndetësës, në vitin 1958.

Në kushtet e Luftës së Ftohtë, në një epokë sfiduese për Shqipërinë dhe me teknologji të panjohura më parë, Petriti e udhëhoqi ekuipazhin e tij në detyra të rënda luftarake me përkushtim të lartë dhe vendosmëri të rrallë. Detarët e nëndetësës i besuan pa mëdyshje, duke ndjerë tek ai jo vetëm komandantin, por edhe shokun, mikun dhe mbrojtësin. Drejtimi i një nëndetëseje në thellësi të Adriatikut, Jonit e deri në Mesdhe, në thellësi 200 metra, ishte një mision me rrezik të jashtëzakonshëm, por që falë aftësisë dhe profesionalizmit të tij u përballua me sukses.



Petrit Myftiu shkëlqeu edhe si udhëheqës strategjik dhe edukator i brezave të oficerëve të rinj. Ai dha një kontribut të jashtëzakonshëm në përgatitjen e kuadrove të nëndetëseve dhe të shtabit të brigadës, ku spikati si organizator, planifikues dhe drejtues i stërvitjeve luftarake, deri në zonat më të thella si Gjiri i Sirtës.

I njohur për karakterin e tij të dashur, buzëqeshjen karakteristike dhe humorin fin, komandant Petriti krijoi lidhje të ngushta me marinarët, qytetarët e Vlorës e të Orikumit, si dhe me komunitetin përreth repartit ushtarak. Ai ishte njeri i fjalës, punës dhe i urtësisë, një shembull frymëzimi për të gjithë ata që shërbyen në flotën shqiptare.

Veç figurës së lavdishme ushtarake, Petrit Myftiu është edhe një emër i nderuar në letërsinë historike ushtarake. Me një stil të pasur, të saktë dhe tërheqës, ai ka botuar katër libra me karakter historik e kujtimeve që përshkruajnë me realizëm jetën, sfidat dhe emocionet e forcave detare shqiptare. Librat e tij janë jo vetëm pasqyrë e historisë sonë detare, por edhe vepra që pasurojnë trashëgiminë kulturore dhe identitare të ushtrisë shqiptare. Komandant Petriti është një figurë që përfaqëson dinjitetin, trimërinë, përkushtimin dhe dashurinë për Atdheun në çdo hap të jetës së tij. Nga kabina e nëndetësës, deri te faqet e kujtimeve që ka lënë pas, ai mbetet një nga figurat më të ndritura dhe frymëzuese të Flotës Luftarake Detare, një komandant i parë, një oficer i madh dhe një atdhetar i pashoq.



ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

Dashuria që nuk e njih Wi-Fi-n

Në dekadat e fundit, rrjetet sociale kanë hyrë fuqishëm në jetën tonë, duke e ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si komunikojmë, si ndajmë ndjenja, dhe si ndërtojmë apo ruajmë marrëdhëniet tona. Ato nuk janë më thjesht mjete të komunikimit, janë shndërruar në hapësira ku projektojmë versionin më të bukur dhe shpesh më të idealizuar të vetes dhe jetës sonë.

Por në këtë realitet të ndërtuar me foto të kuruara, me statuse emocionale dhe me një zinxhir të pafund “like”-sh dhe komentesh, lind pyetja themelore: po ku është dashuria e vërtetë? A kemi mbetur vetëm me hijen e saj dixhitale?

Relacionet njerëzore në epokën dixhitale:

Afër në ekran, larg në shpirt

Nuk është e rrallë të shohësh njerëz që shpërndajnë urime të përzemërta për ditëlindje, për festa familjare apo përkujtime, për hallën, dajën, tezen, mbesën, madje edhe për të afërm që s’janë takuar për vite me radhë.

Ndërkohë, shumë nga këta njerëz jetojnë në të njëjtin qytet, ndoshta edhe në të njëjtën lagje, por nuk e gjejnë kohën për një vizitë apo për një kafe të përbashkët. Kjo sjellje përbën një fenomen të ri shoqëror, ku ndjenja reale zëvendësohet me gjeste virtuale, dhe lidhjet familjare reduktohen në “kujtime” të shpërndara online. Kjo nuk është thjesht një çështje stili jetese, është një krizë e vlerave.

Një urim në Facebook nuk ka peshën morale të një përqafimi të sinqertë. Një koment me emoji nuk e ngroh shpirtin e një njeriu që ndjen mungesë. Ky është një shkëmbim iluzioni me realitetin, ku duken të gjithë të lidhur, por ndihen të vetmuar.

Çfarë po humbasim? Kriza e kontaktit human

Në thelb, njeriu ka nevojë për kontakt të drejtpërdrejtë, për ndjesi të ndara fizikisht dhe emocionalisht me të tjerët.

Sot, gjithnjë e më pak njerëz e përjetojnë këtë lidhje në mënyrë të natyrshme. Gjithçka duket sikur ndodh përmes ekranit, madje edhe dhimbja, gëzimi apo nostalgjia.

E përbashkëta që po humbasim është pikërisht kuptimi moral i marrëdhënieve njerëzore: prania, koha, kujdesi, fjala e mirë në momentin e duhur.

Shpirti nuk mund të ushqehet me pëlqime, dhe dashuria nuk lulëzon përmes ndjekësve.

Kur një njeri i afërt pret në heshtje një telefonatë, një trokitje në derë, një vizitë të papritur, ne duhet të pyesim veten: a është e ndershme që këtë njeri ta kujtojmë vetëm për një ditë në formë postimi, por ta harrojmë për 364 ditët e tjera të vitit?

A po e zëvendësojmë dashurinë me performancën publike?

Nëse akti i dashurisë apo kujdesit ndaj dikujt ndodh vetëm atëherë kur është i dukshëm për të tjerët, atëherë ai akt humbet sinqeritetin e tij. Dashuria e vërtetë është diskrete, intime, pa nevojë për duartrokitje.

